

Ekskluzive

Ekskluzive | Kokainë te këmbët e shoferit në Mercedes – Policia bastis shtëpinë e 32-vjeçarit në Prizren, gjen edhe marihuanë, municion e pajisje tjera



Foto ilustruese



Sinjali.com

18 Gusht 2026 08:18



Një kontroll policor i një veture në Prizren ka çuar në zbulimin e substancave të dyshuara narkotike dhe më pas në bastisjen e shtëpisë së shoferit, ku janë gjetur edhe marihuanë, fishekë, gëzhoja, peshore elektronike dhe një pushkë ajrore, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është **Valdrin Kryeziu 32-vjeçar**, i cili pas përfundimit të veprimeve hetimore është ndaluar për 48 orë.



Rasti ka nisur më 17 gusht, rreth orës 05:30, në rrugën “Gani Saramati” në Prizren, kur një patrullë policore ka ndaluar një veturë Mercedes-Benz.

Sipas informacioneve që ka mësuar Sinjali, gjatë ndalimit policët kanë vërejtur pluhur të bardhë te këmbët e shoferit, çka ka ngritur dyshime dhe ka bërë që të kontrollohen si 32-vjeçari, ashtu edhe automjeti.

Gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar 0.72 gramë substancë e dyshuar kokainë, një peshore elektronike, një pajisje elektronike – detektor, si dhe një palë dylbi.

Por rasti nuk ka përfunduar me kontrollin e veturës.

Pas konsultimit me Prokurorin e Shtetit, Policia ka vazhduar me kontrollin e shtëpisë së Kryeziut, ku janë gjetur edhe prova të tjera.

Sipas të dhënave të rastit, në shtëpi janë sekuestruar 7.26 gramë substancë e dyshuar marihuanë, dy gëzhoja dhe pesë fishekë të kalibrit ende të papërcaktuar, dy peshore elektronike, një pushkë ajrore “Hatsan Striker” 5.5 mm pa numër serik dhe një këllëf pistolette.

Pas gjetjeve, në rast është përfshirë edhe Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë – Njësia në Prizren, e cila ka marrë përsipër hetimet e mëtejshme.

Kryeziu është intervistuar dhe më pas, me aktvendim të Prokurorit të Shtetit, është ndaluar për 48 orë.

Rasti po hetohet nën dyshimet për “Posedim të paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

kokainë

Të tjera:




Kapen 46 kilogramë kanabis në Rinas, dy valixhet me drogë vinin nga Toronto

Shqipëri



Ekskluzive | Ky është i dyshuari që u kap me mbi 100 gramë kokainë në kufirin e Vërmicës

Ekskluzive



Mbante armë dhe kokainë, arrestohet administratori i një lokali në Sarandë

Shqipëri




Ekskluzive | Kokainë, heroinë, armë e mijëra euro cash – këta janë të arrestuarit e aksionit t...

Ekskluzive



Bastisje në Gjakovë, katër persona përfundojnë në ndalim – iu gjenden kokainë,...

Siguri



Arrestohet 37-vjeçari në Tiranë, furnizonte shpërndarësit e kokainës

Shqipëri



“Goditje historike kontrabandistëve të drogës”, sekuestrohen mbi 5 tonë kokainë në...

Botë



Ekskluzive: Këta janë dy të arrestuarit që u kapën gjatë aksionit kundër drogës në Prizren

Ekskluzive

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera